



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Beledijesi

PROPOZIM :

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafi 1, pika 1.3 e Statutit të Komunës së Gjiçanit, (01.Nr.016-126211 të dt.06.11.2014), në zbatim të nenit 6, paragrafi 1 dhe 2 , nenit 7, paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe nenit 8 e Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, me Rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa , 01.Nr.113/2016, të dates 23.05.2016 , Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me date 31.05.2016, miraton :

V E N D I M

Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për periudhë afatgjatë (30 vite), për ndërtimin e “Shtëpisë për të Moshuar”.

1. Kuvendi i Komunës së Gjiçanit Aprovon Propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën afatgjatë prej 30 vite, me pagesë, pjesën e ngastrës kadastrale nga :

- Njësia kadastrale P-70403013-01382-0, lloji i njësisë : parcelë; lloji i pronës: pronë shoqërore; sipërfaqja e parcelës : 35950 m²; vendi i quajtur: “Zabeli i Sahit Agës”; lloji i shfrytëzimit të parcelës: kullosë; klasa e kualitetit të parcelës : kullosë e klasit 3; Zona Kadastrale Gjiçan; pronari: Pasuri Shoqërore Sekretariati i Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore i Komunës së Gjiçanit.

Sipërfaqja e cila ipet në shfrytëzim nga parcela e cekur më lartë është: 10000 m² (1ha)

2. Prona e përshkruar në pikën (1) të Vendimit, respektivisht sipërfaqja prej 10000 m² ipet në shfrytëzim për ndërtimin e “Shtëpisë për të Moshuarit” , për periudhën prej 30 viteve, me qëllim të realizimit të interesit publik investimeve në ofrimin e përkujdesit për të moshuarit.

3. Obligohet Komisioni Vlerësues i Ofertave që pasë plotfuqishmërisë së këtij Vendimi, t’i zbatojë procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën afatgjatë në përputhje me dispozitat e nenit 8 dhe 9 të Ligjit Nr.04/L-144, dhe me dispozitat e Rregullores QRK Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të cilat realizohen përmes konkurrencës së hapur publike, me konkurs publik në formë të ankandit.

4. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë obligohet që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ta bënë parcelimin e sipërfaqës dhe të njejtën t'a regjistron në librat kadastral pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, si pronë e dhënë në shfrytëzim në emër të përfituesit për periudhën afatgjatë për 30 vite.

Të ardhurat të cilat do të inkasohen nga dhënia në shfrytëzim të kësaj prone, janë para publike dhe i nënshtrohen respektimit të dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-52217
Gjilan, më 31.05.2016

Kryesuesja e Kuvendit

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/